



BASHKIA GJIROKASTËR

PROGRAMI I TRANSPARENCËS PËR BASHKINË GJIROKASTËR

I. HYRJE

Programi i Transparencës vlerësohet si një mënyrë konkrete, përmes së cilës Bashkia Gjirokastrë ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale, nën garancinë e ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Bashkia Gjirokastrë do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me bazën ligjore si më sipër. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Bashkisë Gjirokastrë nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.bashkiagjirokastrë.gov.al si dhe në Sportelet e Shërbimit me Një Ndalesë. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afatin kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Bashkisë Gjirokastrë, është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë dhe në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi i Transparencës i Bashkisë Gjirokastrë janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese, e parashikuar në nenin 23 të saj, si një e drejtë e garantuar.

2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: Bashkia Gjirokastrë ushtron funksion publik, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e Bashkisë Gjirokastrë, Këshillit të Bashkisë dhe përkatësisht: ligji nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” dhe ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme nga të gjithë.

5. Organi mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

6. Rishikimi i Programit të Transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:

- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i kuptueshëm;
- i thjeshtë në konsultim;
- i përditësuar;
- i saktë;
- i plotë.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe me përmbajtje si më poshtë vijon:

1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit:

a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

b) tekstet e plota:

i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

ii) të ligjeve;

iii) të akteve nënligjore;

iv) të kodeve të sjelljes;

v) të çdo dokumenti politikash;

vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër, që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;

c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik 3 vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncensionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:

i) listën e kontratave të lidhura;

ii) shumën e kontraktuar;

iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;

iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;

j) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

2. Autoriteti publik, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje dixhitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

3. Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike.

Në përputhje me këtë program transparence, Bashkia Gjirokastrë vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit:

- Tekstet e plota të ligjeve, të akteve nënligjore, ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për publikun e gjerë;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorsit për të drejtën e informimit dhe kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjeve në fuqi;
- Strukturën dhe nivelin e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë;

- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Strukturën organizative të Bashkisë Gjirokastrë;
- Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato,
- Informacione dhe çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Bashkisë Gjirokastrë,
- Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që Bashkia Gjirokastrë, krijon dhe arkivon;
- Një kopje dixhitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që publiku e merr pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.
- Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË BASHKISË GJIROKASTËR

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d të ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit”	Organigrama, Struktura e pagave, Funksionet dhe detyrat e Autoritetit Publik, Institucionet e varësisë	Menjëherë pas konfirmimit të ligjshmërisë së aktit sipa përcaktimeve të bëra në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastër	Koordinatori; Drejtoria e Burimeve Njerëzore;
Akte ndërkombëtare; ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b të ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit”	Ligji nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligji 8517, datë 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil”, Ligji 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligji 44/2015”Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”	Menjëherë pas botimit në fletoren zyrtare. Pas miratimit të urdhrin nga Kryetari.	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastër Në stendën e publikimeve të institucionit.	Koordinatori; Drejtoria e Burimeve Njerëzore;
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim,	Neni 7/1/c/g të ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit”	Ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Informacion shpjegues për	Menjëherë pas miratimit të programit transparencës së Bashkisë Gjirokastër.	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastër	Koordinatori; Drejtoria e Burimeve Njerëzore;

adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.		procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim. Formularin-tip për kërkesë për informacion, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim			
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/ 1/ç të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”	Dokument me informacion të detajuar me të dhëna për vendndodhjen e zyrave të Bashkisë Gjirokastrë, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Menjëherë pas miratimit të programit të transparencës së Bashkisë Gjirokastrë.	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastrë	Koordinatori;
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”	Përshkrimi i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”	Menjëherë pas miratimit të programit të transparencës së Bashkisë Gjirokastrë.	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastrë	Koordinatori; Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Zyra Juridike
Mekanizmat monitorues; raporte audit; dokumentet me tregues performance	Neni 7/ 1/dh të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”	Mekanizmat monitories, raporte audit, dokumente me tregues performance.	Menjëherë pas përfundimit zyrtar të kontrollit të autoritetit auditues.	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastrë	Koordinatori; Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Zyra Juridike; Sektori i Auditimit të Brendshëm;

Buxheti	Neni 7/1/e të ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit	VKB “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2017”	Menjëherë pas konfirmimit të ligjshmërisë së aktit sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastër	Koordinatori; Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar; Zyra Juridike;
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë të ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit”	Ligji nr.9643, date 20.12.2006 “Per prokurimin Publik”; Ligji nr.125/2013 “Per koncensionet dhe partneritetin publik privat”; Regjistri i prokurimeve	Menjëherë pas dërgimit në APP https://www.app.gov.al/	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastër	Koordinatori; Sektori i Prokurimeve Publike
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f të ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit”	Informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut.	Menjëherë	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastër	Koordinatori; Drejtoritë sipas shërbimeve
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/g të ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit”	p/akt ligjor dhe nënligjor	Në momentin kur kërkohen konsultime me publikun.	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastër	Koordinatori; Zyra Juridike; Drejtoritë përkatëse
Mbajtja e dokumentacionit nga institucioni i bashkisë.	Neni 7/1/h të ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit”	Vendime; Skema organizative; Rregullore; Udhëzime; Urdhra; Ligje; Plane; Strategji; Raporte; Rezoluta; Marrëveshje; Relacione; Rekomandime; Korrespondencë; Njoftime; Opinione; Dokumenta etj.	Bazuar në Ligjin Nr. 9154, Dt. 06/11/2003 “Per arkivat” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, menjëherë pas miratimit të urdhrit.	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastër	Koordinatori; Zyra Juridike; Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Sektori i Protokoll – Arkivës.
Regjistri i	Neni 7/1/i	Regjistri i	Menjëherë	Në faqen	Koordinatori;

kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji nr.119/2014 “Për të drejten e informimit”	të ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit”	kërkesave dhe përgjigjeve sipas nenit 8 të Ligjit nr.119/2014.		zyrtare të Bashkisë Gjirokastrër	Zyra me një ndalesë; Zyra e Protokoll – Arkivës
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k të ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit”	Formularë aplikimi.	Menjëherë	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastrër	Koordinatori; Sporteli i shërbimit me një ndalesë
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l të ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit”	Të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak; Njoftimet e punësimit me të dhëna sipas përcaktimeve të bëra nga Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”; Informacione mbi aktivitetet e Bashkisë;	Sipas afateve ligjore të miratimit dhe publikimit të tyre.	Në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastrër	Koordinatori; Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Zyra Juridike; Drejtoritë përkatëse sipas aktiviteteve që zhvillojnë; Sekretari i Këshillit të Bashkisë.

Sektori IT ka për detyrë mirëmbajtjen e faqes zyrtare për mbarëvajtjen dhe realizimin e procesit të punës.

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence, Bashkia Gjirokastrër vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit <http://www.bashkiagjirokaster.gov.al> dhe në mjediset e Sportelit të Shërbimit me Një Ndalesë, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Transparenca”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

KOORDINATOR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

K R Y E T A R

Zamira Rami